

CARELESS COMMUNICATION OF YOUNG PEOPLE KOMUNIKIMI I SHKUJDESUR I TË RINJVE

Albulena ZULBEARI¹

¹ *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

**Corresponding author e-mail: albulena.zulbeari@unite.edu.mk*

Abstract

This study relies on live speech, I say so because the whole paper is created by looking closely at how young people communicate with each other. Tetovo is a city which in addition to high schools which are six, there are also two universities, that creates a diversity in communication between young people, why do I say so, because in addition to the villages of Tetova, we have here many students who come from different cities, with their arrival they bring also many new words and expressions which very spontaneously started to become part of the vocabulary of young people. Such discourse creates another form of communication, creates a language which is far from the standard language, as they speak carelessly, disrespecting grammatical norms, not articulating words properly and use a host of foreign words.

They are often not even aware that by using free phrases that they express at the moment of the lecture, at the same time they create stable phrases, as the free ones, express them in figurative forms and by dressing them with emotional properties they serve thus the language in some form. Such discourse is becoming so modern today that we hear it in all countries, with little exception, only on the school premises, but now that they are closed, it is up to us to try to protect the language from the abuse they are doing.

Keywords: *communication, language, carelessness, form, youth.*

Përmbledhje

Ky punim mbështetet në të folurën e gjallë, them kështu pasi i gjithë punimi është i krijuar duke parë nga afër se si të rinjtë komunikojnë njëri me tjetrin. Tetova është një qytet i cili përveç shkollave të mesme të cilat janë gjashtë, ka edhe dy universitete gjë e cila krijon një laramani në komunikimin mes të rinjve, pse them kështu, pasi përveç fshatrave të Tetovës këtu kemi edhe shumë studentë të cilët vijnë nga qytete të ndryshme. Me ardhjen e tyre këtu ata sjellin edhe shumë fjalë e shprehje të reja të cilat në mënyrë shumë spontane fillojnë e bëhen pjesë e fjalorit të të rinjve. Ligjërimi i tillë krijon një formë tjetër të komunikimit, krijon një gjuhë e cila largohet mjaftueshëm nga gjuha standarde, pasi ata flasin në formë të shkujdesur, duke mos i respektuar normat gramatikore, duke mos i nyjtuar fjalët ashtu siç duhet e duke përdorur një mori të fjalëve të huaja.

Ata shpeshherë nuk janë edhe të vetëdijshëm se duke përdorur togfjalësha të lirë që i shprehin në momentin e ligjërimin, ata njëkohësisht krijojnë togfjalësha të qëndrueshëm, pasi ato të lirët i shprehin në forma të figurshme e duke u veshur veti emocionale e me këtë i shërbejnë edhe gjuhës në një farë forme. Ligjërimi i tillë sot po bëhet shumë modern saqë e dëgjojmë në të gjitha vendet, përjashtim të vogël bëjnë vetëm ambientet shkollore, por që tani edhe ato janë të mbyllura e na mbetet ne që të mundohemi ta mbrojmë gjuhën nga keqpërdorimi që po i bëjnë.

Fjalët kyçe: *komunikim, gjuhë, shkujdesje, formë, të rinjtë.*

1. Hyrje

Në këtë punim jemi munduar të paraqesim komunikimin e çrregullt i cili zhvillohet mes të rinjve tetovarë. Duke jetuar në këto kohë moderne shohim se të rinjtë sa më shumë mundohen t'i largohen gjuhës letrare shqipe. Komunikimi i tyre në të folurën joformale nuk bazohet në asnjë normë letrare, ata nuk respektojnë as drejtshqiptimin e fjalëve, as nuk respektojnë norma drejtshkrimore, Në bisedat mes të rinjve dallohen dy lloj shprehjesh: konstatuese dhe ekzekutuese,²⁹ flasin një fjalë në shqip e një tjetër në gjuhën angleze, kemi shumë fjalë të cilat i shqiptojnë ashtu si i flasin në krahinat e tyre.

Kjo pra ka qenë arsyeja bazë për të cilën e kemi bërë këtë hulumtim, të shohim më nga afër rininë se në çfarë gjuhe ajo komunikon. Në këtë punim kemi trajtuar disa shprehje të cilat ata i përdorin në përditshmërinë e tyre, fjalë të cilat i shprehin në forma të ndryshme letrare, idioma të ndryshme, por që nuk janë të vetëdijshëm për përdorimin e tyre. Në vijim po i shohim shprehjet të cilat janë më të shpeshta dhe më të përdorura nga rinia jonë.

2. Komunikimi i shkujdesur i të rinjve

Në këtë ligjërime takojmë fjalë të cilave u bashkëngjiten kuptime të tjera, për qëllim që të thuhet sa më i plotë mendimi i shprehësit. Tipare që i bën të dallohen këto janë: shpejtësia e artikulimit të fjalëve dhe shprehjeve, mosshqiptimi i disa prej tingujve, intonacioni, jo saktësia e nyjetimit etj. Si tipar kryesor në këtë pjesë mund ta përmendim përdorimin e mbiemrave pozitiv për të shprehur diçka negative (pezhorativ) për ta bërë më të madhe shprehjen, si: jashtëzakonisht është budalla. Formë tjetër e këtij ligjërimi janë edhe përdorimi i fjalëve tabu, ato i hasim tek sharjet, tek temat kur i kanë në lidhje me marrëdhëniet seksuale etj. mund të themi se e folura vulgare është një tipar që e karakterizon ligjërimin e lirë të të rinjve.

Në bazë të asaj se si përdoren fjalët dhe shprehjet fitojnë edhe kuptime të tjera semantike dhe në këtë raste ato shndërrohen edhe në figura letrare si metafore, metonimi, krahasime, epitete etj. Në të folurën e Tetovës nuk mund të mos jetë karakteristik mospërdorimi i drejtë i normave: drejtshkrimin dhe i drejtshqiptimit të fjalëve dhe shprehjeve, mospërdorimi i drejtë i foljeve në kohën e duhur, i emrave dhe mbiemrave në rasën e duhur etj.p.sh.: mapa sosit provimi (pastaj mbaron provimi që duhet të jetë pastaj do të mbarojë provimi), morra tadal duhet mora të dal, u thuj tshkojmë që duhet thuaju të shkojmë etj.

Ky lloj komunikimi quhet komunikim inovativ, sepse vazhdimisht e pasuron gjuhën standarde në mënyra të ndryshme.³⁰ Përfundimisht mund të themi se shprehjet e tilla janë të sajura nga vetë ata të cilët i përdorin dhe mandej të njëjtat shprehje të sajura marrin përmasa në një rreth të caktuar shoqëror. Format të cilat i përmendëm më lart janë bërë pjesë e fjalorit të të rinjve bashkë me shprehjet krahinore, shumë fjalë përdoren me kuptime të figurshme të cilat nuk i kishim më herët, kemi mjaft polisemi dhe një mori togfjalëshash të rinj të cilët janë pjesë e pandashme e fjalorit të gjeneratave të reja. Po ilustrim disa me shembuj:

➤ Ti dukesh më e bukur live (në realitet) - kjo shprehje përdoret me kuptim negativ edhe pse kur e dëgjojmë të thuhet duket si pozitive, por zakonisht shprehet për ato vajza të cilat publikojnë shumë fotografi në rrjetet sociale dhe për t'ia vënë në dukje këtë se na mërzi me to, të rinjtë shprehen që më mirë dukesh në realitet.

²⁹ Lloshi, Xh., Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, Tiranë, 2001, f. 333.

³⁰ Juachoerin., The grammar of slang, Berkeley, 2006, f. 1.

➤ U bë nxehtë këtu - kur e dëgjojmë këtë shprehje e shohim se është një fjali e thjeshtë dëftore, dhe nga kuptimi leksikor tregon se është nxehtë, por kjo shprehje përdoret në ato raste kur prania e ndonjërit është e tepërt dhe nuk e durojnë dot, apo kur vinë ndonjë vajzë që është veshur pak më hapur.

➤ Ah xhi m'ha...vaktin (kohën e lirë) - kjo shprehje përdoret për të shprehur një emocion, por në kuptimin pezhorativ, mund të cilësohet edhe si shprehje banale. Ajo të cilën e kuptojmë nga kjo shprehje ka shumë rëndësi intonacioni me të cilin shprehet, pra mund të ketë një intonacion ku tregon ah ç'më humbe kohën e lirë, ose në një formë tjetër pra e shprehur me një intonacion ndryshe kjo shprehje hyn te shprehjet banale. Nuk mund të themi se është një shprehje brenda grupi, por kjo varësisht nga shprehësi kuptohet në mënyrën që ai e shpreh.

➤ Vini çelsin (vendosja çelësin) – kjo shprehje është një metaforë e cila përbëhet nga folja vendos që në këtë rast është në kohën e pakryer dhe emri çelësi i cili është në rasën kallëzore. Kjo shprehje ka kuptimin mbylle gojën, mos fol, shprehja e tillë në kontekstin e tillë shpreh një urdhër, por këtë lloj shprehje mund ta dëgjojmë edhe në raste të tjera, si vini çelsin dhe mos u mer me at (vendosja çelësin dhe mos u merr me atë) që në këtë rast ka kuptim tjetër, pra mos diskuto me atë njeri, ose përfundo gjithçka. (2) Ngjashëm si kjo shprehje përdoret edhe vinja kapakin (vendosja kapakun) që gjithashtu është një shprehje që përbëhet nga folja vendos dhe emri kapaku i cili gjithashtu është në rasën kallëzore, edhe në këtë kontekst kjo shprehje përdoret për, mbylle gojën ose përfundoje një marrëdhënie apo diçka të tillë.

➤ Wow e papame – kjo shprehje ose ndryshe thënë ky epitete përdoret qoftë për mashkull ose për femër në këtë kuptimin e parë si diçka shumë e mirë, fantastike, por shpesh e dëgjojmë të shprehen sidomos studentët e përmendin këtë lloj epitete në këtë kuptim të dytë që do ta tregojmë tani, e papame në si din tët mashtroje, pra (një mashtruese shumë e zonja) që në këtë rast ka kuptim negativ.

➤ Bak bak – kjo është një shprehje nga gjuha turke, ku në gjuhën shqipe është folja shiko, duke qenë të vetëdijshëm se këto kohë kanalet televizive transmetojnë shumë telenovela në gjuhën turke, kjo ka ndikuar edhe tek populli. Të rinjtë këtu bëjnë pjesë edhe nxënësit edhe studentët e përdorin këtë shprehje si shiko shiko si është bërë me kuptim pozitiv, por e njëjta përdoret edhe me kuptim negativ kur duan të ironizojnë dikë shprehen me një shprehje të tillë.

➤ Linë se drasë asht (leje se dërrasë është) – kjo shprehje gjithashtu ka dy kuptime në kuptimin e parë përdoret për nxënësit dhe studentët të cilët nuk mësojnë fare dhe në kuptimin e dytë përdoret për ata që konsumojnë alkool, pra leje se nuk është në vetëdije. Në të dyja rastet kjo shprehje përdoret me kuptim negativ.

➤ Shtet nvti (shtet në veti)- fjala shtet në këtë shprehje përdoret në formë figurative për dikë i cili ka shumë vetëbesim dhe nuk do t'ia di për atë se çfarë bëhet rreth tij, është i sigurt në punët e tij, në fjalët e tij etj.

➤ E qajta – kjo shprehje vinë nga folja qajë, që në këtë rast përdoret, kur duan të tregojnë që testin apo provimin e kanë punuar shumë mirë dhe janë të kënaqur nga puna e tyre.

➤ Ja doxha (ia dogja) – edhe në këtë rast kemi një shprehje e cila është e ndjekur nga folja djeg, po që në këtë rast përdoret në disa kuptime, në kuptimin e parë nxënësit dhe studentët e përdorin këtë shprehje kur tregojnë se kanë kopjuar në një provim dhe profesori nuk ka mundur t'i shoh, në kuptimin e dytë sidomos sido mos nga nxënësit përdoret ia dogja ika nga ora, pra kur profesori ka pyetur me notë dhe ai ka ikur nga mësimi.

➤ Lajta/ lajtëm (përfunduar) – në këtë rast e kemi foljen laj e cila përdoret në mënyrë figurative për të treguar se mbaruam apo përfunduar, p.sh.: kur profesori i pyet nxënësit me notë, por nuk u ka treguar paraprakisht dhe ata nuk janë të përgatitur për atë notim dhe shprehen që

përfundiam do marrim nota të dobëta. Gjithashtu edhe në rast se janë duke kopjuar dhe profesori i sheh shprehen në një formë të tillë, pra mbarova më zuri profesori.

➤ Eh bossi be – bossi është fjalë nga gjuha angleze që në këtë rast shprehet për dikë i cili nuk ka frik, është shumë i zoti, për dikë i cili ka blerë një orë të mirë, ose një pallto të shtrenjtë, siç e shohim kjo shprehje përdoret në formë të figurshme dhe ka shumë polisemi, por kryesisht të gjitha janë me kuptim pozitiv, varësisht nga rasti dhe konteksti jo shprehje përdoret edhe si një ironi.

➤ Ti ske ftajrë (ti s'ke fytyrë) është një shprehje e cila përdoret në formë të figurshme, për dikë i cili nuk ka edukatë, nuk ka sjellje, për dikë i cili ka mashtruar ose gënjyer dhe shprehen në formë të tillë.

➤ Traku se je harxhit – (hesht se je harxhuar)- kjo shprehje përdoret kur të rinjtë dëshirojnë t'i tregojnë ndonjë shoku ose shoqe që nuk ka çfarë të tregojë më shumë, të gjithë e dinë kapacitetin e tij ose saj dhe shprehen në këtë formë, pra je harxhuar nuk ke çfarë të japësh më shumë, por e gjitha kjo përmban dozë ironie në vete.

➤ U nxeh situata (u nxeh situata) – kjo shprehje përdoret kur në një bisedë e sipër ngrihen tonet e zërit ndërmjet shokëve, pra biseda merr rrjedhën e një debati të fuqishëm dhe thuhet që u nxeh situata, u bë biseda shumë e fortë.

3. Përfundimi

Nga e gjithë kjo arrijmë në një përfundim se të rinjtë përdorin shumë shprehje figurative për të cilat nuk janë të vetëdijshëm që i përdorin. Shprehjet e tilla përdoren me qëllim që ata të përçojnë një mesazh të koduar tek shoku a grupi i cili i dëgjon.

Gabimet drejtshkrimore, shprehjet shpeshherë të pakuptueshme, deformimi i fjalëve, ngjyrimet shumë të forta, shprehjet emocionale, shkëputja e thënieve etj., janë tipare kryesore të leksikut të ligjërimit të shkujdesur.

Vërejmë se gjatë bisedimit më nuk dëgjojmë fjalë e shprehje të gjuhës standarde, por kemi një ligjërim të thjeshtë i cili është kryekëput i bazuar në dialekt dhe në krahinorizma. Kemi një mënyrë të shprehurit të drejtpërdrejtë, shumë emocione ku mbizotëron ana subjektive e folësit ku në masë të madhe shkellet norma e standardit. Gjatë bashkëbisedimeve vërejmë përsëritje të shumta të fjalëve, ndërprerje të panevojshme, shpesh herë dëgjojmë dhe një komunikim rruge në ambiente ku nuk duhet, kemi një kumtim jo të denjë të frazave dhe një ligjërim të shkujdesur.

Kjo detyron na takon neve si pedagogë që të punojmë më shumë në këtë aspekt dhe të mundohemi në maksimum ta ndërpresim një komunikim të tillë i cili gjuhën standarde shqipe e çon drejt një degradimi të madh.

Referencat

- [1]. Bajçinsa, I., *Çështje të shqipes së stome letrare vështruar në aspektin teorik e të zbatimit në praktikë*. Tiranë, 1992.
- [2]. Beci, B., *Gjuha letrare shqipe dhe bazat e saj dialektore*. Tiranë, 1995.
- [3]. Çabej, E. *Studime gjuhësore*. Prishtinë, 1975.
- [4]. Gjinari, J., & Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*. Tiranë. 2003.
- [5]. Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhës Shqipe*. Tiranë, 2001.
- [6]. Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*. Tiranë, 2001.
- [7]. Juachoerin., *The grammar of slang*, Berkeley. 2006.